



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 403 Akti

**Nr. 525 Vendimi
Tiranë, më 27.4.2022**

V E N D I M

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 21.4.2022, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore lidhur me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Znj. Fida Osmani, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga av. A. S..

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

pasi dëgjoi rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi dëgjoi në seancë dëgjimore Znj. Fida Osmani, dhe përfaqësuesen e saj ligjore av. Antoneta Sevdari si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Znj. Fida Osmani është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për shkak të funksionit si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, znj. Fida Osmani i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Valbona Sanxhaktari, Olsi Komici dhe Xhensila Pine (relatore).
3. Komisioni administroi nga institucionet ndihmëse të procesit raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në

vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

4. Trupi gjykues, pas studimit të raporteve të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, filloi hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Trupi gjykues caktoi kryesues komisioneren Valbona Sanxhaktari dhe deklaroi mungesën e konfliktit të interesit.

5. Trupi gjykues, me vendimin nr.2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Fida Osmani, bazuar në kriterin e rivlerësimit të pasurisë; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, lidhur me kriterin e rivlerësimit të pasurisë referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave, thirrjen e dëshmitarëve dhe afatin e ushtrimit të tyre.

6. Në datë 31.3.2021, subjektit iu dërguan rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit për kriterin e pasurisë, për sjelljen e provave dhe shpjegimeve për të provuar të kundërtën e barrës së provës. Brenda afatit ligjor subjekti depozitoi provat dhe shpjegimet të cilat u administruan dhe u analizuan nga trupi gjykues para vendimmarrjes përfundimtare.

I. SEANCA DËGJIMORE

7. Në datën 21.4.2022, ora 13:00, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe vëzhguesit ndërkombëtar.

7.1. Në përfundim të seancës dëgjimore, trupi gjykues ftoi subjektin të shprehte qëndrimin përfundimtar për procesin e rivlerësimit. Përfaqësuesja ligjore e subjektit kërkoi çelje të hetimit administrativ për dy kriteret e tjera të kontrollit të figurës dhe vlerësimin profesional.

7.2. Seanca për shpalljen e vendimit të trupit gjykues u zhvillua në datën 27.4.2022, ora 9:30.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT/ HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

A. Vlerësimi i pasurisë

8. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë të subjektit të rivlerësimit, Znj. Fida Osmani ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit ka konstatuar se:

- *deklarimet e subjektit, ndër vite, nuk janë të sakta në përputhje me ligjin;*
- *është i paqartë burimi financiar i përdorur për transaksionet e konfirmuara nga DPPP;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

8.1. Komisioni kreu një hetim të pavarur bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në vendimet nr. 2 dhe nr. 17 të vitit 2017, të Gjykatës Kushtetuese, duke kryer një sërë veprimesh verifikuese hetimore për verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit të bërë nga ky subjekt, të dhënave të pasqyruara dhe përfundimeve të nxjerra nga kontrolli i kryer nga ILDKPKI-ja, bazuar në dokumentacionin dhe provat shkresore të administruara në dosje.

8.2. Nga analiza e të dhënave të vetëdeklaruarra nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike/vjetore (DPV) dhe atë të rivlerësimit kalimtar (deklarata *Vetting*), të dorëzuara në ILDKPKI verifikimi i materialeve shkresore të administruara në këtë dosje dhe të dhënave të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, ka rezultuar si vijon:

9. Lidhur me pasurinë apartament banimi sip. 95.6 m², rruga “**”, Tiranë**

9.1. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, me shkresën nr. **** prot., datë 18.6.2020, informoi Komisionin se shtetasit E., Fida dhe K. Osmani janë bashkëpronarë të pasurisë apartament me sip. 95.60 m², nr. ****, z. k. ****, me vlerë 90.720 euro. Në dokumentacionin e ASHK-së ndodhet kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me rezervë pronësie për apartament banimi me palë blerëse shtetasit K., Fida dhe E. Osmani dhe palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k.

9.2. Me aktmarrëveshjen për ndërtim dhe dorëzim apartamenti, datë 23.3.2016, lidhur midis shoqërisë tregtare “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit dhe shtetasit E. O., në cilësinë e porositësit, sipërmarrësi ka marrë përsipër të ndërtojë për llogari të porositësit një apartament në godinën që do të ndërtohet në rrugën “****”, sipas lejes së ndërtimit. Apartamenti i porositur përbëhet nga 2+1 me sipërfaqe të përgjithshme 108 m², me çmim 90.720 euro. E gjithë shuma prej 90.720 euro do të likuidohej brenda datës 23.3.2017. Porositësi do të paguajë në formën e kaparit një shumë prej 25.000 euro nga data 23.3.2016 deri në lidhjen e kontratës përfundimtare pas regjistrimit të apartamentit. Afati maksimal i pagimit të çmimit është më 25.3.2017. Në rast vonese në pagesa porositësi do të paguajë penalitete në masën 10% për çdo ditë vonesë.

9.3. Sipas aneks aktmarrëveshjes, datës 25.3.2017, palët konfirmojnë faktin se nga data 25.3.2016 e deri më 25.3.2017 porositësi ka paguar me këste shumën 25.000 euro, gjithashtu, porositësi ka aplikuar për kredi në shumën 65.720 euro, e cila ende nuk i është akorduar. Afati i pagimit të çmimit zgjatet për tre muaj deri më 25.6.2017, në të kundërt kontrata do të zgjidhet.

9.4. Komisioni, pasi analizoi provat dhe deklaratimet e subjektit në pyetësorë, vlerësoi faktin se subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, duke shkelur detyrimet e përcaktuara nga ligji nr. 84/2016, si dhe ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, neni 4, ndonëse ka pasur një aktmarrëveshje me shoqërinë e ndërtimit “****” sh.p.k., datë 23.3.2016, për blerjen e këtij apartamenti, si dhe ka lidhur një kontratë për furnizim me energji elektrike në datën 23.2.2016. Në datën 18.7.2016 kjo pasuri rezultoi e regjistruar në emër të shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k.

9.5. Kjo pasuri nuk është deklaruar nga subjekti dhe personat e lidhur në deklaratën *Vetting*.

9.6. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2017, subjekti ka deklaruar te formulari i ndryshimeve të interesave private: Blerë apartament banimi me sip. 95.60 m², në rrugën “****”, Tiranë. Çmimi 90.720 euro, me burim: (i) kredi nga “Intesa Sanpaolo Bank”. Kredimarrës djali E. O. , kontratë kredie nr. 755/518, datë 5.7.2017. Dorëzanës Fida dhe K. Osmani. Kontratë dorëzanie nr. ****, datë 5.7.2017, shuma 9.000.000 lekë; (ii) kursime të familjes në vlerën 1.300.000 lekë; (iii) hua nga vëllai Sh. S. në vlerën 14.000 euro.

9.7. Në pyetësorin nr. 2, subjekti në lidhje me këtë pasuri ndër të tjera ka deklaruar se: “*Në mars të vitit 2016 kanë filluar bisedimet me shoqërinë ndërtuese për blerjen e një apartamenti në rrugën ‘****’. Me aktmarrëveshjen, datë 23.3.2016, lidhur midis E. O. dhe shoqërisë ‘****’ sh.p.k. u ra dakord për një apartament 2+1, çmimin e të cilit do ta paguanim me kursimet nga të ardhurat e familjes dhe me kredi bankare. Kjo aktmarrëveshje ka qenë një veprim paraprak me kusht, realizimi i së cilës varej nga një kusht i përcaktuar (kredia). Sipas aktmarrëveshjes*

shoqëria kërkonte pagimin tërësisht të çmimit të pasurisë në momentin e dorëzimit të tij dhe lidhjes së kontratës së shitjes.

Ndërkohë nga ana e saj u kërkua detyrimi ynë për të paguar një kapar në shumën 25.000 euro, qoftë edhe me këste, deri në lidhjen e kontratës përfundimtare pas regjistrimit të apartamentit. Në aktmarrëveshje është përcaktuar se afati maksimal i pagimit të çmimit të apartamentit është data 23.3.2017.

Ndërkohë, nga ana jonë ishte paguar me këste shuma prej 25.000 euro, por u dakordësuar që deklarimi i pagimit të kësaj shume do të bëhej nëse marrëveshja midis palëve do të realizohej. Në datën 16.6.2017 u lidh kontrata për shitblerje të pasurisë së paluajtshme me rezervë pronësie. Në datën 7.7.2017 u lidh kontrata e kredisë. Burimet financiare për blerjen e këtij apartamenti janë kursimet nga të ardhurat e familjes, huaja e deklaruar në shumën 14.000 euro dhe kredia bankare në shumën 9.000.000 lekë (65.720 euro)”.

9.8. Subjekti i ka dërguar Komisionit dokumentacionin vijues: (i) kontratë hipotekimi nr. ***, datë 4.7.2017, lidhur midis hipotekuesit “****” sh.p.k. dhe përfituesit “Intesa Sanpaolo Bank”; (ii) kontratë kredie bankare nr. ***, datë 5.7.2017, lidhur midis kredidhënësit “Intesa Sanpaolo Bank” dhe kredimarrësit E. O., për dhënie e kredisë në shumën 9.000.000 lekë; (iii) kontratë dorëzanie nr. 756/519/2, datë 5.7.2017, lidhur midis përfituesit “Intesa Sanpaolo Bank” dhe dorëzanësve K. dhe Fida Osmani; (iv) aktmarrëveshje për ndërtim dhe dorëzim apartamenti datë 23.3.2016; (v) aneks i aktmarrëveshjes së datës 23.3.2016, i cili mban datën 25.3.2017; (vi) kontratë për shitblerjen e pasurisë së paluajtshme me rezervë, datë 16.6.2017, kontratë hipotekimi, kontratë e kredisë dhe kontratë e dorëzanisë; (vii) mandatpagesa përfitues shoqëria “****” sh.p.k.

9.9. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë deklaruar aktmarrëveshjen për blerjen e apartamentit, datë 23.3.2016, lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., për një apartament 2+1 me sip. 95.6 m², për blerjen e kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* në shkëlqje të ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, dalë për zbatim të ligjit nr. 84/2016, duke mos deklaruar dhe pagesat e bëra ndaj shoqërisë dhe as detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., si dhe nuk e kanë deklaruar këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, duke shkëlqur detyrimet e përcaktuara nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

9.10. Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, deklaroi se: “*Së bashku me E. dhe K. O. jemi bashkëpronarë të pasurisë nr. ***, z. k. ***, pasuri e llojit apartament me sipërfaqe 95.60 m², me vlerë 90.720 euro, blerë sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me rezervë pronësie datë 16.6.2017. Ky apartament është deklaruar në DPV-në e vitit 2017, me çmim 90.720 euro, me burim: (i) kredi nga ‘Intesa Sanpaolo Bank’, kredimarrës djali E. O., kontratë kredie nr. ***, datë 5.7.2017. dorëzanës Fida dhe K. Osmani. Kontratë dorëzanie nr. ***, datë 5.7.2017, shuma 9.000.000 lekë; (ii) kursime të familjes në vlerën 1.300.000 lekë; (iii) hua nga vëllai Sh. S në vlerën 14.000 euro.*

*Në pyetësorin nr. 2 kam sqaruar Komisionin në lidhje me mosdeklarimin e aktmarrëveshjes, datë 23.3.2016, lidhur midis Endit Osmanit dhe shoqërisë “****” sh.p.k. Pranoj faktin që nuk kam deklaruar në DPV-në e vitit 2016 dhe atë *Vetting*, aktmarrëveshjen për blerjen e apartamentit, datë 23.3.2016, si dhe të drejtat dhe detyrimet që kanë rrjedhur nga kjo aktmarrëveshje. Kjo pasaktësi ka ardhur për faktin se është mbajtur parasysh momenti ligjor i kalimit të pronësisë dhe regjistrimi i pasurisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme.*

Kam vlerësuar gjithmonë se ky është momenti i deklarimit të pasurisë. Në kushtet kur familja ime ka pasur mundësi financiare të krijojë këtë pasuri me të ardhura të ligjshme kjo pasaktësi nuk mund të jenë shkak për marrjen e masës disiplinore. Institucionet e rivlerësimit kanë konsoliduar tashmë jurisprudencën e tyre duke theksuar se pasaktësitë si në DPV-të vjetore ashtu edhe në deklaratën Vetting të pashoqëruara me pamjaftueshmëri financiare, nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

9.11. Trupi gjykues, mbështetur në dokumentacionin e disponuar nga hetimi administrativ, në shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të barrës së provës, si dhe në deklaratimet e subjektit në seancë, arsyeton se:

9/12. Neni D, pikat 1, 2 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës, neni 32, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016 dhe formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit 2017, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarimin saktë dhe mjaftueshëm të pasurisë së saj.

9.13. Trupi gjykues, pasi vlerësoi provat e administruara, dëgjoi subjektin në pyetësor, prapësimet pas kalimit të barrës së provës, arsyeton se bazuar në faktet dhe rrethanat e konstatuara subjekti dhe personat e lidhur kanë nënshkruar aktmarrëveshjen e datës 23.3.2016, me anë të së cilës ka porositur një apartament banimi në rrugën “****”, Tiranë, në godinën që do të ndërtohej nga shoqëria “****” sh.p.k.

9.14. Aktmarrëveshja e datës 23.3.2016 ka vijuar të zbatohet me kryerjen e pagesave nga ana e subjektit dhe personit të lidhur gjatë vitit 2016 për këtë pasuri ndaj shoqërisë ndërtimore “****” sh.p.k.

9.15. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në zbatim të neneve 30 dhe 31 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, kishte detyrimin të deklaronte marrëdhënien më këtë pasuri.

9.16. Neni 3, pika 11, e ligjit nr. 84/2016, parashikon: *“Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ‘Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’”*, i ndryshuar, që janë në pronësi, zotërim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

9.17. Në kontekst të kësaj situatë faktike dhe ligjore, subjekti i rivlerësimit kishte ndërgjegjësimin e duhur për të deklaruar këtë marrëdhënie në deklaratën Vetting dhe kishte detyrimin të bënte në të shpjegimet e nevojshme dhe kjo sjellje e subjektit, nëse do të kishte ndodhur, do vlerësohej si një vullnet i qartë për të deklaruar gjithçka në përputhje me ligjin, duke prezantuar rrethanat që përcaktonin situatën.

9.18. Mosdeklarimi i kësaj marrëdhënieje të krijuar mes palëve në deklaratën Vetting dhe as i pagesave të kryera apo detyrimeve financiare të mbetura ndaj shoqërisë ndërtuese konsiderohen nga trupi gjykues si përpjekje e subjektit dhe e personave të lidhur me të për të shmangur kontrollin e kësaj pasurie, në bazë të ligjit nr. 84/2016.

9.19. Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuara së bashku, deklaratimet e subjektit gjatë hetimit dhe shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- i) në referencë të pikave 1 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur ndodhen në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, pasi nuk e kanë

deklaruar këtë pasuri për të cilën ishin marrë hapa ligjore dhe kishte kryer pagesa shoqërisë ndërtuese para plotësimit të deklaratës *Vetting*;

10. Lidhur me pasuritë apartament 3+1, me sip. 147 m², bulevardi “**”, Tiranë dhe apartament me sip. 80 m², në ***, Durrës**

a) Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar këtë apartament në bashkëpronësi me bashkëshortin K. O., në zotërim që nga viti 2002, blerë me kredi nga shteti në shumën 5.000.000 lekë dhe kursimet e familjes. Apartamenti është në vlerën 6.400.000 lekë, me sip. 147 m².

10.1. Në bazë të kontratës së porosisë me nr. ***, datë 18.6.2002, lidhur midis shtetasit K. O. dhe shoqërisë “****” sh.p.k., çmimi i apartamentit rezulton 6.400.000 lekë dhe 1.600 USD.

10.2. Likuidimi do të kryhet: vlera prej 2.500.000 lekë do të likuidohet nga kredia e dhënë në Bankën e Kursimeve; diferenca në vlerën 3.900.000 lekë do të paguhet me marrjen në dorëzim të apartamentit. Vlera 1.600 USD është paguar nga porositësi me pagesë të menjëhershme në momentin e lidhjes së kësaj kontrate.

10.3. Gjatë hetimit rezultoi se në dosjen e dhënies së kredisë shtetasit K. O. nga ish-Banka e Kursimeve Tirana ¹, ndodhet edhe kontrata e dorëzimit me nr. ***, datë 6.11.2003, me dorëzues R. H., administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “****” sh.p.k., huamarrës K. O. dhe huadhënës dega e Bankës së Kursimeve Tiranë. Objekti i kësaj kontrate është hipotekimi i pasurisë së paluajtshme të dorëzuesit R. H. në dobi të huadhënësit, për të siguruar përmbushjen e detyrimit të huas së dhënë huamarrësit K. O., në shumën 2.500.000 lekë.

10.4. Subjekti ka lidhur kontratë sipërmarrje me shoqërinë “****” sh.p.k. në datën 26.4.2001 dhe më pas bashkëshorti i subjektit ka lidhur kontratën e porosisë me nr. ***, datë 18.6.2002 dhe aneksin e kontratës së porosisë me nr. ***, datë 18.7.2003, me shoqërinë “****” sh.p.k., për blerjen e një apartamenti që po ndërtohej nga sipërmarrësi. Djali i subjektit ka lidhur kontratë në datën 3.8.2004, me shoqërinë “****” sh.p.k., duke porositur apartament me sip. 80 m², në ***, Durrës, me çmimin 400 USD/m² (vlera në total 32.000 USD). Pagesa është likuiduar plotësisht më 3.8.2004.

10.5. Në pyetësin nr. 2, subjekti, pyetjes së Komisionit se me çfarë pasuri u garantua kredia, i është përgjigjur se: *“Në kushtet kur nuk kishim në pronësi asnjë pasuri të paluajtshme nga ana e ortakut dhe administratorit të shoqërisë ‘***’ sh.p.k. është vënë në hipotekë një apartament me sipërfaqe 111 m² i ndodhur në Tiranë, rruga ‘***’, me kontratë dorëzanie nr. ***, datë 3.7.2002”*.

b) Në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur/fëmija madhor, bashkë me prindërit ka deklaruar: *Apartament 1+1 ***, ***, Durrës, me sipërfaqe 80 m², regjistruar në ZVRPP-në Durrës në pronësi të shtetasit E. O. me nr. regj. hipotekor ***, datë 11.7.2006, blerë me kursimet e familjes. Vlera: 32.000 USD.*

10.6. Subjekti, ndër të tjera, i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë datë 3.8.2004 midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasit E. O. , i cili ka porositur apartament me sip. 80 m², në ***, Durrës, me çmimin 400 USD/m² (vlera në total 32.000 USD). Pagesa është likuiduar plotësisht më 3.8.2004.

10.7. Në DPV-në e vitit 2004 dhe në DPV-në e vitit 2005 në formularin e ndryshimeve të pasurisë, si subjekti i rivlerësimit, personi i lidhur, ashtu edhe fëmija madhor bashkë me prindërit nuk e kanë deklaruar këtë pasuri.

¹Dokumentacionin e dorëzuar nga “Raiffeisen Bank” në Komision.

10.8. Në DPV-në e vitit 2006, në ndryshimet e interesave private pasuri të paluajshme dhe të luajshme, subjekti ka deklaruar apartament 1+1, Plazh, Durrës, reregjistruar në ZVRPP-në Durrës, në pronësi të djalit E. O., shuma 32.000 USD. Në këtë deklaratë, gjithashtu, është evidentuar se: *“... shuma prej 3.000.000 lekësh e deklaruar në vitet 2003 dhe 2004 është përdorur tërësisht për blerjen dhe kompletimin e banesës së deklaruar në emër të djalit ...”*.

10.9. Në kontratën e shitblerjes, datë 30.5.2006, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe palë blerëse E. O., pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, në adresën: Lagjja ***, ***, Durrës, me sip. 80 m², çmimi i shitjes është në vlerën 24.800 euro, e cila është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale.

Në lidhje me situatën e konfliktit të interesit

10.10. Komisioni ka hetuar në lidhje me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 15.10.2021, informon Komisionin se nga verifikimet e kryera në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore rezultojnë të jenë dhënë këto vendime nga subjekti: (i) vendim nr. ***, datë 2.4.2003, me palë paditëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe të paditur A. H., me objekt zgjidhje kontratës së sipërmarrjes; (ii) vendim nr. ***, datë 22.12.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me palë paditëse R. H. dhe të paditur shoqërinë “****”, me objekt anulim fature shërbimi; (iii) vendim nr. ***, datë 29.3.2002, me palë paditëse E. M. dhe të paditur shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt pavlefshmëri e kontratës së shitjes; (iv) vendim nr. ***, datë 17.4.2002, me palë paditës E. V. etj. dhe të paditur M. K. etj., shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktmarrëveshjes, lirimim dhe dorëzimin nga ana e shoqërisë “****” sh.p.k. të sipërfaqes së truallit prej 428 m².

10.11. Subjekti është pyetur në pyetësin nr. 2 nëse ka pasur në shqyrtim çështje gjyqësore me palë shoqërinë “****-****” sh.p.k. ose me ortakë apo administratorë të saj. Subjekti, ndër të tjera, deklaron se: *“Nga verifikimi që kam kryer me rezulton se kam shqyrtuar disa çështje në të cilat ka qenë palë edhe shoqëria ‘****’ sh.p.k. apo ortakë i saj². Me lejoni të sqaroj faktin se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë numri i dorëheqjeve të pranuar ka qenë shumë i vogël, duke u vendosur para detyrimit ligjor të vijimit të gjykimit edhe pas vlerësimit të kundërt nga ana e gjyqtarit. Konkretisht, kam vlerësuar se nuk mund të gjykoj çështje ku palë ka qenë shoqëria ‘****’ sh.a., pasi djali im ushtron detyrën e juristit prej më shumë se 10 vjetësh, për shkak të mospranimit të kërkesave për heqje dorë nga gjykimi, unë kam vijuar me gjykimin e këtyre çështjeve”*.

10.12. Komisioni, bazuar në ligjin nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, analizon se konflikti i interesit është gjendja e konfliktit mes detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, i cili duhet të kryejë në mënyrë të drejtë dhe me përgjegjësi detyrat. Në kuptim të nenit 5, pika 1, germa “a”, të ligjit të sipërcituar, marrëdhënia juridike civile e lidhur midis bashkëshortit të subjektit dhe shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. me karakter pasuror, përbën interes privat të gjyqtarit.

10.13. Nisur nga rrethanat e çështjes në lidhje me pasuritë në fjalë, përderisa rezulton ekzistenca e interesave private në kuptim të ligjit nr. 9367, /2005, por edhe në kuptim të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte dhënë dorëheqjen nga

²Çështja civile nr. *** vendimi, datë 29.3.2002; çështja civile nr. *** vendimi, datë 17.4.2002, me palë paditëse E. V. etj. dhe të paditur M. K. etj., shoqëria “****” sh.p.k.; çështja civile nr. *** vendimi, datë 2.4.2003; çështja civile nr. *** vendimi, datë 22.12.2005, me palë paditëse R. H. dhe të paditur shoqëria “****” sh.a.; çështja civile nr. *** vendimi, datë 11.10.2010, me palë ndërgjyqëse midis të tjerash edhe shoqëria “****” sh.p.k.; çështja civile me nr. *** vendimi, datë 17.09.2012; çështja civile me nr. *** vendimi, datë 24.12.2012.

gjykimi i çështjeve gjyqësore, ku palë ndërgjyqëse ka qenë shoqëria “****” sh.p.k. dhe/ose administratori dhe ortakut i saj, shtetasi R. H., trupi gjykues i Komisionit, pasi mori në shqyrtim provat shkresore, përgjigjet e subjektit në pyetësorë, si dhe duke pasur si orientim vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit³, vlerëson se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit kur ka gjykuar këto çështje.

10.14. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se ka shqyrtuar në kushtet e konfliktit në vendimmarrjet: (i) vendim nr. ***, datë 2.4.2003, me palë paditëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe të paditur A. H., me objekt zgjidhje kontrate të sipërmarrjes; (ii) vendimi nr. ***, datë 22.12.2005, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me palë paditëse R. H. dhe të paditur shoqërinë “****”; (iii) vendim nr. ***, datë 29.3.2002, me palë paditëse E. M. dhe të paditur shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt pavlefshmëria e kontratës së shitjes; (iv) vendim nr. 1584, datë 17.4.2002, me palë paditës E. V. etj. Dhe të paditur M. K. etj., shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktmarrëveshjes, lirimim dhe dorëzimit nga shoqëria “****” sh.p.k. të sipërfaqes së truallit prej 428 m². Subjekti ndodhet në situatën faktike të parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “d”, e ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

10.15. Subjekti, ndër të tjera, deklaron se: *“Në lidhje me konfliktin e interesit me shoqërinë ‘****’ sh.p.k. sqarohet se çështjet gjyqësore me palë shoqërinë ‘****’ sh.p.k. kanë zgjidhjet si më poshtë: çështja civile me nr. *** vendimi, datë 29.3.2002, ku është vendosur pushimi i gjykimit; çështja civile me nr. *** vendimi, datë 17.4.2002, me palë ndërgjyqëse paditës E. V. etj., të paditur M. K. etj., shoqëria ‘****’ është vendosur pushimi i gjykimit; çështja civile me nr. 1347 vendimi, datë 2.4.2003, është vendosur pushimi i gjykimit; çështja civile me nr. *** vendimi, datë 22.12.2005, me palë paditëse RR. H., i paditur shoqëria ‘****’ sh.a.. Objekt i kësaj çështje është ‘anulimi i pjesshëm i faturës së shërbimit telefonik’ në shumën 43,648 lekë. Në lidhje me shqyrtimin e këtyre çështjeve nuk gjendem në situatën e parashikuar nga neni 72, në pikat nga 1 deri 5 të tij të Kodit të Procedurës Civile.*

Ndërkohë që ligji nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka hyrë në fuqi në vitin 2005, për çështjet e shqyrtuara në vitet përpara se të hynte në fuqi ky ligj nuk mund të konkludohet se janë në kushtet e shkëlqes së ligjit të sipërcituar për shkak se ky ligj në këtë kohë nuk ekzistonte”.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

10.16. Trupi gjykues, mbështetur në dokumentacionin e disponuar nga hetimi administrativ, në shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të barrës së provës, si dhe në deklaratimet e subjektit në seancë, arsyeton se:

10.17. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë sanksionon parimet bazë të një procesi të rregull ligjor. Liria dhe të drejtat e njohura nga Kushtetuta nuk mund të cenohen pa një proces të rregull ligjor. Kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik.

10.18. Këto parime si parimi i ligjshmërisë, i pavarësisë së gjykatës, i paanësisë së gjykatës etj. janë të sanksionuara edhe në Kodin e Procedurës Civile. Paanshmëria e gjyqtarëve në gjykim nënkupton mosndikimin e tyre prej të tretëve dhe në mënyrë të veçantë nga asnjëra prej palëve në proces, duke mundësuar një gjykim të drejtë dhe të paparagjykuar të çështjes.

³Vendimet nr. 10/2019 (JR), nr. 16/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

10.19. Në funksion të këtij parimi, Kodi i Procedurës Civile (nenet 72-76)⁴ parashikon rastet e heqjes dorë dhe përjashtimit të gjyqtarit nga gjykimi i çështjes, me qëllim shmangien e dyshimeve të arsyeshme për cenim të parimit të paanësisë në gjykim.

10.20. Duke mos dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjeve të mësipërme, subjekti ka cenuar parimin e paanshmërisë së gjykatës, duke gjykuar çështje me palë shoqërinë “****” sh.p.k., me të cilën kishte dhe vazhdon të këtë marrëdhënie pasurore dhe dorëzanie.

10.21. Pretendimi i subjektit, se deri në vitin 2005 nuk kishte dalë ligji për konfliktin e interesit dhe për çështjet që ka gjykuar dhe marrë vendim para këtij viti nuk ka qenë në konflikt interesi, vjen në kundërshtim me parashikimet ligjore të sanksionuara në Kushtetutë dhe në Kodin e Procedurës Civile të sipërcituara, të cilat përcaktojnë parimet e paanësisë dhe pavarësisë së pushtetit gjyqësor, parime të cilat nuk janë respektuar nga subjekti.

10.22. Provat dhe faktet që rezultuan nga hetimi administrativ, evidentuan se midis subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur me të dhe shoqërisë së ndërtimit ka pasur marrëdhënie juridike rezultuar në shitblerjen e pasurisë apartament banimi 3+1, me sip. 147 m², ndodhur në bulevardin “***”, Tiranë dhe apartament banimi me sip. 80 m², në ***, Durrës, duke e vendosur subjektin në kushtet e mosrespektimit të nenit 72/3 të Kodit të Procedurës Civile.

10.23. Nga një vlerësim në tërësi i çështjes, subjekti i rivlerësimit Fida Osmani nuk ka vepruar për të shmangur situata të konfliktit faktik të interesit, parë kjo edhe me rëndësinë që ka besimi dhe perceptimi i publikut në pavarësinë, etikën, integritetin dhe paanshmërinë që magjistrati duhet të kujdeset të reflektojë. Ky detyrim, përveç se gjen rregullim specifik në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjin nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, ka gjetur vend edhe në ligjin e posaçëm nr. 96/2016, për statusin e magjistratëve, nenet 367 e 468 dhe vijues të tij.

10.24. Trupi gjykues, në konkluzion, vlerëson se subjekti në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore, ku palë ka qenë shoqëria “****” sh.p.k., ndërtuese e dy pasurive të paluajtshme të subjektit dhe personave të lidhur me të, ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, parashikuar nga germa “d”, pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

11. Lidhur me pasurinë njësi shërbimi zyrë, me sip. 43.81 m², Rruga *, Tiranë**

11.1. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar njësi shërbimi (zyrë), me sip. 43.81 m², ndodhur në Tiranë, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë sipas certifikatës për vërtetim pronësie me nr. serie ***, datë 5.3.2013, në bashkëpronësi me bashkëshortin K. O., blerë me kursimet e familjes në vite. Vlera: 52.572 euro.

11.2. Referuar deklaramëve të interesave private vjetore në ILDKPKI, rezulton se: (i) në DPV-në e vitit 2010, në formularin e ndryshimit të interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, subjekti ka deklaruar ambient zyrë, i ndodhur në Rrugën ***, porositur në shoqërinë “****” sh.p.k., paguar një kësht në shumën 8.000 euro; (ii) në DPV-në e vitit 2011, në formularin e detyrimeve, ka deklaruar ambient zyrë, i ndodhur në Rrugën ***, porositur në shoqërinë “****” sh.p.k., paguar kështet, shuma e shlyer 10.000 euro, mbetur 32.000 euro; (iii) në DPV-në e vitit 2012, në formularin e ndryshimeve të interesave private, ka deklaruar ambient zyrë, i ndodhur në Rrugën ***, porositur në shoqërinë “****” sh.p.k., paguar kështet, shuma e shlyer 7.575 euro sipas mandatpagesës nr. ***, datë 4.5.2012; (iv) në DPV-në e vitit 2013, në formularin e detyrimeve, ka deklaruar pagesë kështi për zyrën, porositur në shoqërinë “****” sh.p.k., shuma 5.000 euro. Detyrim i mbetur: 6.002 euro.

⁴Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996, është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 9, 10, 11, datë 12.5.1996.

11.3. Me kontratën e porosisë, datë 10.5.2010, porositësi K. O. ka porositur pranë shoqërisë sipërmarrëse “***” sh.p.k. një dyqan me sipërfaqe totale 48.45 m², sipërfaqe neto 43.81 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 4.64 m² në pallatin 6-7-katësh, ndodhur në Rrugën ***, Tiranë. Çmimi është 1.200 euro/m², me shumë totale 52.572 euro dhe porositësi ka për të likuiduar 8.000 euro dhe diferenca do të likuidohet me këste. Afati i dorëzimit të objektit është 31.12.2010.

11.4. Me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, datë 8.2.2013, blerësi K. O. ka blerë nga shitësit, shoqëria “***” sh.p.k., I. dhe M. H., njësinë e shërbimit zyrë, kundrejt çmimit 1.400 euro/m², në total 61.334 euro, shumë e cila është likuiduar totalisht nga blerësi jashtë zyrës noteriale. Kjo pasuri është transkriptuar në emër të blerësit K. O., i cili është pajisur me certifikatë pronësie. Sipas kartelës së pronës, shuma e paguar për këtë pasuri është 61.334 euro. Me shkresën nr. *** prot., datë 18.6.2020, ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Jug⁵, konfirmon pasurinë njësi, me sip. 43.81 m², në emër të shtetasit K. O., shuma e paguar: 61.334 euro.

11.5. Në pyetësin nr. 2 subjekti është pyetur nga Komisioni në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie në shumën 61.334 euro, ku ka sqaruar se: *“Njësia e shërbimit me sip. 43.81 m² është blerë më kursimet e familjes në vite. Prenotimi i saj është bërë më kontratë porosie, datë 10.5.2010, kundrejt çmimit 1.200 euro/m², në shumën 52.572 euro. Në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 8.2.2013, është shkruar gabim çmimi i shitblerjes në shumën prej 61.334 euro. Burimi i të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie kanë qenë të ardhurat nga puna e tri anëtarëve të familjes, unë, bashkëshorti dhe djali, për të cilat janë paraqitur vërtetimet nga punëdhënësit përkatës në deklaratimet periodike dhe në deklaratën Vetting”*.

11.6. Sa i takon çmimit të blerjes së kësaj pasurie, Komisioni, pasi analizoi provat dhe deklaratimet e subjektit në pyetësorë, bazuar në pikën 4⁶, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, ka vlerësuar që çmimi i blerjes së kësaj pasurie është 61.334 euro, pasi kjo vlerë rezulton në kontratën e shitblerjes dhe në kartelën e pasurisë, si vlera e cila u provua lidhur me ligjshmërinë në formë dhe përmbajtje të mënyrës së fitimit të pronësisë.

11.7. Komisioni vlerësoi në analizën e treguesve financiarë të pasqyrojë pagesën e shumëve totale prej 61.334 euro me këste, përkatësisht: në vitin 2010 shuma 8.000 euro (referuar kontratës së porosisë dhe deklaratimit vjetor në vitin 2010 si e paguar në datën 10.5.2010); në vitin 2011 shuma 10.000 euro (sipas deklaratimit të subjektit në DPV-në e vitit 2011); në vitin 2012 shuma 7.575 euro (sipas deklaratimit periodik të subjektit në DPV-në e vitit 2012); si dhe në vitin 2013 shuma 35.759 euro (diferenca e mbetur nga shuma totale e çmimit të blerjes):

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2010 – 10.5.2010	
Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga puna e subjekti, dokumentuar për periudhën	482.776
Të ardhurat <i>neto</i> nga puna e bashkëshortit, dokumentuar për periudhën	462.992
Të ardhurat <i>neto</i> nga puna e djalit, dokumentuar për periudhën	316.340
Total të ardhura/të hyra financiare	1.262.108
Shpenzime kredie në Raiffeisen Bank për periudhën	118.845
Shpenzime për udhëtim dhe qëndrime jashtë vendit, për periudhën	0

⁵Kthim përgjigjeje shkresës nr. *** prot., datë 13.5.2020, të Komisionit.

⁶Neni 49, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, parashikon: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes”*.

Shpenzime me MC djali në “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 5.5.2010	12.184
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI, për periudhën	194.637
Total shpenzime/të dala financiare	325.666
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> , deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
Ndryshim mj. monetare bankë, dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	-172.790
Mjete monetare të disponueshme (1)	763.652
Blerje autoveturë “Volkswagen Polo”, me targa ***, në emër të vajzës, blerë në datën 5.5.2010, në shumën 4.800 euro	657.072
Zyrë me sip. 43.81 m ² , në Rrugën Budi, blerë në shumën 61.334 euro (likuiduar 8.000 euro)	8.511.319
Total pasuri	9.168.391
Detyrime financiare	7.401.159
Pasuri neto (2)	1.767.232
Balanca e fondeve (1-2)	-1.003.580

11.8. Për këstet e tjera deri në vitin 2013, analiza financiare paraqitet në tabelën vijuese:

Analiza e treguesve financiarë	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013
Përshkrimi	Vlera/lekë	Vlera/lekë	Vlera/lekë
Të ardhurat <i>neto</i> nga puna e subjekti, dokumentuar për periudhën	1.138.410	1.124.364	1.188.209
Të ardhurat <i>neto</i> nga puna e bashkëshortit, për periudhën	1.471.062	1.447.032	1.441.286
Të ardhurat <i>neto</i> nga puna e djalit, dokumentuar për periudhën	840.000	910.865	841.584
Të ardhura vajza, bonus	0	4.812	0
Të ardhura nga interesa depozitë në emër të djalit në “Raiffeisen Bank”	13.492	12.817	10.296
Total të ardhura/të hyra financiare	3.462.964	3.499.890	3.481.375
Shpenzime kredie për periudhën	284.716	284.717	284.716
Transaksion në llogari të shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., nga bashkëshorti i subjektit, në shumën 17.000 euro, datë 1.10.2012	0	2.373.030	0
Shpenzime për regjistrimin/sigurime automjeti sipas AMF-së	0	28.652	6.480
Shpenzime për udhëtim dhe qëndrime jashtë vendit për periudhën	389.560	470.000	398.729
Shpenzime për shkollim master, vajza	0	62.400	62.400
Shpenzim pagesa, djali MC	133.740	77.766	234.316
Shpenzim për ZVRPP	0	0	50.120
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI, për periudhën	546.480	558.192	564.096
Total shpenzime/të dala financiare	1.354.496	3.854.757	1.600.857
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> , gj. fillim-gj. fund periudhe	0	0	0
Ndryshim mj. monetare bankë, dokumentuar gj. fillim-gj. fund periudhe	-28.709	55.151	234.805
Mjete monetare të disponueshme (1)	2.079.759	-299.716	2.115.323
Pagesë për blerje zyrë, me sip. 43.81 m ² , në Rrugën ***, blerë në shumën 61.334 euro	1.389.300	1.057.394	5.013.412
Total pasuri	1.389.300	1.057.394	5.013.412
Detyrime financiare	0	0	0

Pasuri neto (2)	1.389.300	1.057.394	5.013.412
Balanca e fondeve (1-2)	690.459	-1.357.110	-2.898.089

11.9. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se: (i) ka mospërputhje në lidhje me çmimin e paguar për blerjen e këtij apartamenti dhe kohën e kryerjes së pagesës, sipas kontratës së shitblerjes dhe deklarimeve të subjektit; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e kryer për blerjen e kësaj pasurie (në datën 10.5.2010 me balancë negative 1.003.580 lekë; në vitin 2012 me balancë negative në vlerën 1.357.110 lekë dhe në vitin 2013 me balancë negative në vlerën 2.898.089 lekë), si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për këto periudha.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

11.10. Subjekti, në lidhje me këtë pasuri, ndër të tjera, deklaron se: *“Me kontratën e porosisë, datë 10.5.2010, K.O. ka porositur pranë shoqërisë ‘Palushi’ sh.p.k. një dyqan me sipërfaqe totale 48.45 m², në Rrugën ***, Tiranë. Çmimi është 1.200 euro/m², në vlerë totale 52.572 euro dhe porositësi ka për të likuiduar 8.000 euro dhe diferencën do ta likuidojë me këste. Afati i dorëzimit të objektit është data 31.12.2010. Me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, datë 8.2.2013, K. O. blen te shoqëria ‘***’ sh.p.k., I. H. dhe M. këtë pasuri. Në kontratë gabimisht është shënuar çmimi prej 1.400 euro/m², në total 61.334 euro. Kjo pasuri është transkriptuar në emër të blerësit K. O., i cili është pajisur me certifikatë pronësie.*

*Pavarësisht se në kontratë, për efekt regjistrimi, është shënuar se vlera është likuiduar totalisht nga blerësi jashtë zyrës noteriale, likuidimi i kësaj pasurie ka vazhduar deri në fund të vitit 2015. Në ILDKPKI kam kryer deklaratimet⁷ përkatëse. Për të kundërshtuar barrën e provës paraqes shkresën nr. *** prot., datë 12.4.202, të shoqërisë ‘***’ sh.p.k., e cila më ka konfirmuar edhe një herë vlerën e zyrës 52.572 euro.*

*Aktrakordimi i datës 3.2.2014, i kryer në vitin 2014 ndërmjet bashkëshortit dhe shoqërisë ‘***’ sh.p.k., nga i cili rezulton se vlera e njësisë është 52.572 euro, 48 mandatarkëtime që tregojnë se pagesa periodike të kryera në vitet 2010 - 2015. Numri i lartë i këtyre mandateve dhe rregullshmëria e tyre tregon tej çdo dyshimi se vlera e apartamentit është në shumën 52.572 euro. Bazuar në parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, nenet 246 e vijues, shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura etj. Ato kanë vlerë të plotë provuese përderisa nuk janë goditur për falsitet. Çmimi i kësaj pasurie është 52.572 euro. Në analizën e vitit 2013 duhet të përfshihet si shpenzim për blerjen e zyrës vetëm pagesa e shumës 5.000 euro, pjesa tjetër, siç është shpjeguar më sipër, është paguar në vitet 2014 dhe 2015 dhe për këtë arsye në analizën financiare të viteve 2014 dhe 2015 duhet të përfshihen si shpenzim shumat 11.997 dhe 10.000 euro”.*

⁷Në DPV-në e vitit 2010, paguar shuma 8.000 euro; në DPV-në e vitit 2011, paguar shuma 10.000 euro mbetur 32.000 euro; në DPV-në e vitit 2012, paguar shuma 7575 euro; në DPV-në e vitit 2013, paguar shuma 5.000 euro; në DPV-në e vitit 2014, paguar shuma prej 11.997 euro. Detyrim i mbetur në shumën 10.000 euro; në DPV-në e vitit 2015, paguar shuma 10.000 euro, deklaruar; pagesë kësti për zyrën porositur në shoqërinë ‘***’ sh.p.k., në shumën 10.000 euro dhe kolonën detyrimi i mbetur pa shlyer është shënuar “likuiduar plotësisht”, për këtë arsye, ndërmjet bashkëshortit dhe shoqërisë ‘***’ sh.p.k. u krye rakordimi i datës 3.2.2014, nga i cili rezulton se detyrimi mbetur pa shlyer, në fund të vitit 2013, ka qenë në shumën 21.997 euro, shumë e cila do të paguhej dhe është paguar gjatë viteve 2014 dhe 2015.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

11.11. Trupi gjykues, mbështetur në dokumentacionin e disponuar nga hetimi administrativ, në shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të barrës së provës, si dhe në deklaratimet e subjektit në seancë, arsyeton se:

11.12. Gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaratimeve të subjektit (në deklaratën *Vetting* dhe deklaratat periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur, si dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

11.13. Subjekti i rivlerësimit, në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*, ka pasur detyrimin të plotësonte të dhënat për çdo pasuri në pronësi, të shpjegonte dhe të provonte mjaftueshëm lidhur me burimin e krijimit të saj, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016.

11.14. Trupi gjykues, sa i takon çmimit të njësisë u bazua në pikën 4⁸, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, ka vlerësuar referuar nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: *“Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklaratimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre, ose për veprimet e kryera prej tyre”*.

11.15. Sipas përmbajtjes së kontratës këto pohime janë nënshkruar nga palët përpara noterit me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë. Kodi i Procedurës Civile ka përcaktuar aktet zyrtare siç është edhe akti noterial si akt që ka fuqi të plotë provuese. Në bazë të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile kontrata e shitjes përbën provë të plotë të deklaratimeve, bërë përpara tyre në tri rastet e parashikuara shprehimisht në ligj:

- deklaratime që janë bërë përpara tyre (në rastin konkret noterit);
- për fakte që kanë ngjarë në prani të tyre;
- në veprimet e kryera prej tyre.

11.16. Sa më sipër, çmimi i blerjes së kësaj pasurie është në vlerën 61.334 euro, pasi ky çmim rezulton të jetë formalizuar dhe dakordësuar nga palët kontraktore në kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme datë 8.2.2013 dhe në procesin e regjistrimit të kësaj pasurie dhe nxjerrjen e kartelës së pasurisë, dhe kjo vlerë provohet lidhur me ligjshmërinë në formë dhe përmbajtje të fitimit të pronësisë.

11.17. Trupi gjykues vlerëson se kontrata e shitblerjes datë 8.2.2013, e hartuar në bazë të dispozitave të Kodit Civil për shitjen e sendeve të paluajtshme, është një akti publik, mbi bazën e të cilin është kryer regjistrimi në ZVRPP-në Tiranë dhe transkriptimi i kontratës në regjistrat hipotekorë ka bërë të njohur ekzistencën e kontratës nga të tretët, si dhe vlerën e pasuar për të⁹.

11.18. Në lidhje me fuqinë provuese të dokumentacionit të sjellë nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, akt rakordimi dhe mandatpagesa të thjeshta, të cilat u analizuan duke iu referuar nenit 9 të ligjit nr. 7661, datë 19.1.1993, “Për kontabilitetin”, i cili parashikon, ndër të tjera, se çdo dokument kontabël mbështetet në një dokument justifikues (fillestar) dhe “kërkesat

⁸Pika 4, e nenit 49, të ligjit nr. 84/2016 parashikon: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelitit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes”*.

⁹Vendim unifikues nr. 1, datë 6.1.2009, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

e formës dhe të vlefshmërisë së dokumenteve justifikuese për t'u pranuar për regjistrime në kontabilitet përcaktohen me regjimet kontabël.

11.19. Kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar." përcaktojnë se dokumenti justifikues bazë përgatitet në kohën kur kryhet veprimi dhe çdo dokument duhet të përmbajë emërtimin e dokumentit, numrin rendor (ose serial), si dhe datën;

11.20. Bazuar në sa më lart, në kundërshtim me rregullat e plotësimit të dokumentit financiar, mandat-pagesat të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si dokument justifikues për pagesën e kësteve të apartamentit krijojnë bindjen se janë të parregullta, pasi atyre iu mungon numri rendor i tyre, referuar datave të lëshimit, sipas detyrimeve ligjore të mësipërme.

11.21. Për sa më sipër, trupi gjykues krijon bindjen se mandatet janë të pabesueshme dhe, për pasojë, pa efekt provues lidhur me pagesën e njësisë. Në referim edhe të vendimmarrjes së Kolegjit nr. 2/2019, datë 4.2.2019, përcaktimi i bërë nga palët në kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme të datës 8.2.2013, në të cilën çmimi total i blerjes së njësisë së shërbimit zyrë prej 61.334 euro, është likuiduar totalisht nuk ka asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në kontratën e shitblerjes të nënshkruar mes palëve, nuk ka as kundërshtim, sipas ligjit të tyre dhe rregullim të pasojave që ato kanë sjellë.

11.22. Nga sa subjekti nuk arriti të shpjegojë dhe të provojë me dokumentacion provues pretendimet lidhur me pasaktësinë e çmimit të kontratës, trupi gjykues arrin në konkluzionin se pretendimet lidhur me vlerën e paguar mbi këtë pasuri mbetën vetëm në kuadër deklarativ.

11.23. Komisioni vlerëson se shuma 61.334 euro u pagua nga viti 2010 deri më 18.2.2013, datë kur palët lidhën kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, ku edhe deklaruan me vullnetin e tyre të lirë dhe të pavesuar dhe, kur pas këtij deklarimi, u transkriptua prona në regjistrat hipotekorë në emër të personit të lidhur me subjektin. Nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në kontratën e shitblerjes të nënshkruar mes palëve, e cila konfirmon vlerën e paguar të çmimit për blerjen e kësaj pasurie, pasi nuk ka as kundërshtim, sipas ligjit, të tyre, as rregullim të pasojave që ato kanë sjellë

11.24. Në lidhje me njësinë e shërbimit zyrë, shuma 1.950.000 lekë, tërhequr *cash* nga llogaria e bashkëshortit në "Raiffeisen Bank", e padeklaruar si transaksion dhe destinacion në vitin 2010 dhe shuma 17.000 euro derdhje nga bashkëshorti i subjektit në llogari të shoqërisë ndërtimore "***" sh.p.k. në datë 1.10.2012, subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe pretendimi se ato nuk ishin transaksione të kryera nga bashkëshorti ngeli vetëm në nivel deklarativ dhe i paprovuar me dokumentacion ligjor provues.

11.25. Trupi gjykues, në analizë të sa më sipër, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me pamundësinë financiare duke arritur në konkluzionin përfundimtar për këtë pasuri se:

i) subjekti dhe bashkëshorti nuk mbulojnë me të ardhura nga burime të ligjshme pagesën e këstit të parë të njësisë, në vitin 2010 duke rezultuar me një diferencë negative prej 1.003.580 lekësh;

ii) subjekti dhe bashkëshorti nuk mbulojnë me të ardhura nga burime të ligjshme pagesën e kësteve të tjerë deri në vitin 2013, duke rezultuar me një diferencë negative për vitin 2012 prej 1.357.110 lekësh dhe me një diferencë negative për vitin 2013 prej 2.898.089 lekësh;

iii) në referencë të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe germës "b", të pikës 5, të nenit 33, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë dhe ka deklarim të pasaktë, pasi vlera e deklaruar në

deklaratën *Vetting* nuk është vlera e dakordësuar prej palëve në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie të paluajtshme në datën 8.2.2013.

12. Automjet tip “Mercedes-Benz”, në emër të djalit E. O.

12.1. Personi i lidhur, fëmijë madhor i subjektit, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar: “*Automjet ‘Mercedes-Benz’ me targa ***, vit prodhimi 2004, blerë në datën 25.3.2008, burimi i krijimit shitja e mjetit me targa ***, në shumën 1.173.333 lekë, pasi i është zbritur nga çmimi i shitjes taksa e kalimit të pronësisë dhe tatimi në burim. Diferenca nga kursimet e familjes. Vlera është 10.200 euro*”.

12.2. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë shitje automjeti nr. ***, datë 14.12.2005, me palë shitëse E. H. dhe palë blerëse E. O. , të automjetit tip “Mercedes-Benz” me targa ***, në vlerën 500.000 lekë; (ii) kontratë shitje automjeti nr. ***, datë 4.12.2007, me palë shitëse E. O. dhe palë blerëse shoqëria “****” e automjetit tip “Mercedes-Benz” me targa ***, në vlerën 1.173.333 lekë; (iii) faturë shitje nr. ***, datë 25.3.2008, e automjetit ***, Avantgarde në çmimin 10.200 euro. Vërtetim datë 5.4.2008.

12.3. Në DPV-në e vitit 2008 subjekti, në ndryshim të interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, ka deklaruar automjet tip “Mercedes-Benz”, në emër të djalit E. O. , datë blerje 25.3.2008, në shumën 10.200 euro.

12.4. Referuar të dhënave nga DPSHTRR-ja¹⁰, konfirmohet i regjistruar në pronësi të shtetasit E. O. automjeti me targa ***, gjithashtu rezulton se: (i) ky automjet është blerë në Bremen, Gjermani, nga shtetasi E. O. me faturë nr. ***, datë 25.3.2008, kundrejt vlerës 10.200 euro (likuiduar *cash*); (ii) me deklaratë doganore ***, datë 31.3.2008, janë shlyer detyrimet doganore në vlerën 485.731 lekë.

12.5. Në DPV-në e vitit 2008, subjekti nuk ka deklaruar burim të ardhurash për blerjen e këtij automjeti, ndërsa në DPV-në e këtij viti të bashkëshortit K. O. (në deklaratën e interesave private të fëmijës madhor, djalit E. O. , në ndryshim të interesave private) është deklaruar: “... *automjet tip ‘Mercedes-Benz E-270’, blerë në datën 31.3.2008, në shumën 10.200 euro, me paratë e depozituara nga shitja e automjetit të mëparshëm në dhjetor 2007 të deklaruara në DIPP-në e vitit 2007*”.

12.6. Në deklaratën e pasurisë së personit të lidhur (pjesë e deklaratës *Vetting*), djali i subjektit ka deklaruar si burim për blerjen e këtij automjeti: (i) të ardhurat nga shitja e automjetit me targa ***, në shumën 1.173.333 lekë; dhe (ii) kursimet e familjes.

i. Kronologjia e blerjes dhe e shitjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa *** dhe të ardhurat

12.7. Në DPV-në e vitit 2005 subjekti, në deklaram të interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, ndër të tjera, ka deklaruar edhe automjetin tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 1994, blerë në pronësi të djalit në datën 14.12.2005, në shumën 500.000 lekë.

12.8. Me kontratë shitje automjeti datë 14.12.2005, shtetasi E. O. ka blerë nga shtetasi E. H., automjetin tip “Mercedes-Benz C220”, vit prodhimi 1994, me targa ***¹¹, kundrejt çmimit të shitjes prej 500.000 lekësh (shumë e likuiduar tërësisht nga blerësi).

12.9. Në bazë të analizës paraprake të treguesve financiarë, të kryer nga Komisioni për vitin 2005, rezulton në dukje se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e likuiditeteve gjendje në llogarinë e pagesës së bashkëshortit (në vlerën 1.010.499 lekë), pagesën

¹⁰Shkresë nr. *** prot., datë 21.5.2020.

¹¹Në këtë kontratë është specifikuar që automjeti rezulton pa të meta apo vese.

e çmimit të blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara në këtë vit (balanca negative në vlerën 589.172 lekë)¹².

12.10. Në DPV-në e vitit 2007, subjekti, në deklaram të interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, ndër të tjera, ka deklaruar: “... *automjet në emër të djalit E. O. , shitur në shumën 9.000 euro, depozituar shuma në ‘Raiffeisen Bank’*”.

12.11. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka depozituar edhe kontratën nr. ***, datë 4.12.2007, me anë të së cilës shtetasi E. O. i ka shitur shoqërisë “****” automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, kundrejt çmimit *bruto* 1.333.333 lekë dhe *neto* 1.173.333 lekë (mbajtur në burim takse kalim pronësie 2% dhe tatim në burim prej 10%).

12.12. Në pyetësin nr. 2, pyetjes së Komisionit se përse çmimi i shitjes së këtij automjeti nga djali i saj është afro 2.5 herë më i lartë se çmimi i blerjes, gati 2 vjet pas përdorimit të tij, subjekti ka shpjeguar se: “*Me kontratën nr. ***, datë 14.12.2005, në emër të djalit është blerë një automjet në shumën 500.000 lekë. Në lidhje me çmimin mendoj se është shfrytëzuar ndonjë ofertë apo periudhë që çmimi i automjeteve ka qenë i favorshëm. Automjeti ka qenë pa ajër të kondicionuar dhe ka pasur nevojë për disa investime të vogla. Pas blerjes i është instaluar kondicioneri dhe janë bërë disa rregullime që kanë rritur vlerën e tij.*

*Me kontratën e shitjes nr. ***, datë 4.12.2007 (dy vjet më pas), automjeti i është shitur shoqërisë ‘****’ në shumën 1.333.333 lekë. Në favor të djalit ka kaluar shuma prej 1.173.333 lekësh, pasi është paguar taksa e kalimit të pronësisë dhe tatimi në burim. Mendoj se është shfrytëzuar tregu kërkesë - ofertë dhe meqë çmimi ka qenë i kënaqshëm është realizuar shitja. Periudha midis blerjes dhe shitjes së automjetit ka qenë relativisht e shkurtër (dy vjet) dhe me investimin që është bërë në mjet, vlera e tij është rritur”.*

12.13. Referuar të dhënave nga “Raiffeisen Bank”¹³, rezulton se në datën 19.12.2007 është transferuar në llogarinë në lekë në emër të shtetasit E. O. (djali i subjektit) shuma 1.173.333 lekë, nga shoqëria “****” me përshkrimin “*pag. sipas kontratës nr. ****”, shumë e cila ka mbetur gjendje në këtë llogari deri në datën 31.12.2007.

12.14. Nisur nga fakti që gjendja në këtë llogari në datën 31.3.2008 rezulton në vlerën 873.624 lekë, tregon se jo e gjithë shuma e përfituar nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa *** është përdorur për blerjen (në Gjermani + shpenzimet e zhdoganimit) të automjetit tip “Mercedes-Benz E270 CDI”.

ii. Kursime familjare

12.15. Bazuar në deklaramet periodike vjetore të subjektit dhe personave të lidhur deri në datën 31.12.2007, nuk rezultojnë likuiditete *cash* në banesë.

12.16. Sa më sipër, nga Komisioni mbështetur në dokumentacionin e disponuar përfshirë edhe deklaramet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, u krye një analizë e treguesve financiarë për harkun kohor 1.1.2008 - 31.3.2008, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, nga burime të deklaruara të ardhurash, për pagesën e çmimit të blerjes dhe shpenzimeve të zhdoganimit të këtij automjeti në shumën 10.200 euro + 485.731 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për këtë periudhë, konkretisht:

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2008 - 31.3.2008	
Përshkrimi	Vlera në lekë

¹²Bashkëlidhur në aneks të shpjegimeve të analizës paraprake të treguesve financiarë.

¹³Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 2.6.2020.

Të ardhurat <i>neto</i> nga puna e subjekti dokumentuar për periudhën	208.087
Të ardhurat <i>neto</i> nga puna e bashkëshortit dokumentuar për periudhën	293.724
Të ardhurat <i>neto</i> nga puna e djalit e dokumentuar për periudhën	0
Total të ardhura /të hyra financiare	501.811
Shpenzime kredie në “Raiffeisen Bank” për periudhën	71.179
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT-it, ILDKPKI-së për periudhën	136.620
Total shpenzime/të dala financiare	207.799
Ndryshim mjete monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	0
Ndryshim mjete monetare bankë dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	274.981
Mjete monetare të disponueshme (1)	568.993
Blerje automjeti tip “Mercedes-Benz E 270 CDI”, duke përfshirë edhe shpenzimet e zhdoganimit datë 31.3.2008	1.751.245
Total pasuri	1.751.245
Detyrime financiare	0
Pasuri <i>neto</i> (2)	1.751.245
Balanca e fondeve (1-2)	-1.182.252

12.17. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime/prova për të provuar të kundërtën e konstatimit të Komisionit, për sa duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e kryer për blerjen dhe shpenzimet e zhdoganimit të automjetit tip “Mercedes-Benz E 270 CDI”, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për harkun kohor 1.1.2008 - 31.3.2008, duke rezultuar me një balancë negative në vlerën 1.182.252 lekë.

12.18. Komisioni, në analizë të provave, vlerëson se kontrata e shitjes datë 4.12.2007 me anë të së cilës automjeti është shitur në vlerën 1.333.333 lekë, me një çmim 2.6 herë më shumë se vlera e blerjes së tij, pasi është përdorur për afro 2 vjet nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe subjekti nuk arriti të provojë vlerën e shpenzimeve për mirëmbajtje dhe përmirësime të kryera nga personi i lidhur për këtë automjet, të cilat kanë sjellë rritjen e vlerës së tij, ngre dyshime të arsyeshme lidhur me vlerën reale të shitjes së kësaj pasurie.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

12.19. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se: “Me kontratën e datës 25.3.2008, djali im E. O. ka blerë automjetin tip ‘Mercedes-Benz’, me targa ***, në vlerën 10.200 euro. Burimi i krijimit të këtij automjeti është shitja e automjetit me targa ***, në shumën 1.173.333 lekë, pasi i është zbritur nga çmimi i shitjes taksa e kalimit të pronësisë dhe tatimi në burim. Diferenca nga kursimet e familjes.

Në DPV-në e vitit 2007, në deklaram të interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, ndër të tjera, kam deklaruar: ‘... automjet në emër të djalit E. O. , shitur në shumën 9.000 euro, depozituar shuma në ‘Raiffeisen Bank’.

Me kontratën nr. ***, datë 14.12.2005, në emër të djalit është blerë një automjet në shumën 500.000 lekë. Ky automjet ka qenë pa ajër të kondicionuar dhe ka pasur nevojë për investime. Në vitin 2006, pas blerjes, automjetit i është instaluar kondicioneri dhe i janë bërë disa rregullime që kanë rritur vlerën e tij. Siç rezultojnë nga analiza financiare e kryer nga Komisioni gjatë këtij viti, ne kemi pasur mundësi të shpenzonin për investimin e kryer në këtë automjet.

*Me kontratën e shitjes nr. ***, datë 4.12.2007, automjeti i është shitur shoqërisë ‘***’ në shumën 1.333.333 lekë. Në favor të djalit ka kaluar shuma prej 1.173.333 lekësh, pasi është paguar taksa e kalimit të pronësisë dhe tatimi në burim. Ashtu siç rezulton nga hetimi administrativ mjeti është blerë nga shtetasi V. H., në Gjermani. Ai ka blerë automjetin për E. O., por me qëllim garancie (pra për të verifikuar plotësisht se mjeti është në gjendje teknike të mirë), pagesa e çmimit të mjetit në favor të këtij shtetasi nuk është kryer menjëherë. Pasi kontaktua me shtetasin V. H., ai na vuri në dispozicion një deklaratë dore të kohës (të cilën ai e kishte ruajtur), nga e cila rezulton se për blerjen e këtij automjeti i është dhënë paradhënie më 18.3.2008 në shumën 2.400 euro. Në prill i është paguar një këst tjetër në shumën 4.000 euro dhe në gusht të po këtij vitit i është paguar kësti i tretë dhe i fundit në shumën 3.800 euro”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

12.20. Trupi gjykues, pasi analizoi provat, deklaratimet e subjektit në pyetësorë dhe prapësimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, vlerësoi se pagesa e kryer për blerjen dhe shpenzimet e zhdoganimit të automjetit tip “Mercedes-Benz E 270 CDI”, provohet se është kryer për sa në datën kur palët lidhën kontratën e shitblerjes së pasurisë së luajtshme, më 31.3.2008, datë kur deklaruan me vullnetin e tyre të lirë dhe të pavesuar se është paguar vlera totale e çmimit.

12.21. Deklarata dorazi që subjekti vuri në dispozicion, sipas së cilës ky çmim u pagua me këste, nuk ka fuqi provuese qoftë nga forma dhe qoftë nga përmbajtja e saj, pasi nuk përmbush kriteret e nenit 261 të Kodit të Procedurës Civile. Trupi gjykues vlerëson se kjo deklaratë ashtu sikurse edhe pretendimet e subjektit mbeten thjesht në nivel deklarativ dhe nuk mund të konfirmojë e vetme dhe jo në harmoni me prova të tjera faktet e deklaruara që kanë ndodhur realisht.

12.22. Sa më sipër, subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës lidhur me pamundësinë financiare të saj dhe personave të lidhur për të justifikuar pagesën e kryer për blerjen dhe shpenzimet e zhdoganimit të automjetit tip “Mercedes-Benz E 270 CDI”, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për harkun kohor 1.1.2008 - 31.3.2008, pasi gjendja në llogarinë bankare ku u pagua çmimi i shitjes së automjetit të mëparshëm në datën 31.3.2008, rezulton në vlerën 873.624 lekë, duke provuar se jo e gjithë shuma e përfituar nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, është përdorur për blerjen (në Gjermani + shpenzimet e zhdoganimit) e automjetit tip “Mercedes-Benz E 270 CDI” dhe subjekti nuk arriti të provojë apo dokumentojë pagesën e pretenduar me këste të këtij automjeti.

12.23. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e kryer për blerjen dhe shpenzimet e zhdoganimit të automjetit tip “Mercedes-Benz E 270 CDI”, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për harkun kohor 1.1.2008 - 31.3.2008, duke rezultuar me një balancë negative në vlerën 1.182.252 lekë duke u ndodhur në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës “b” të nenit 33.

KONKLuzion Përfundimtar

13. Trupi gjykues, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, provat e administruara, rekomandimin e relatores së çështjes, dëgjoji subjektin dhe përfaqësuesen e saj ligjore në seancën dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, arrin në përfundimin se:

- a. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur ndodhen në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm në deklaratën *Vetting*, pasi nuk kanë deklaruar dhe përfshirë në të apartamentin e banimit me sip. 95.6 m², në rrugën “****”, Tiranë, për të cilin kishin marrë hapa ligjorë dhe kishin kryer pagesa shoqërisë ndërtuese, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- b. Subjekti i rivlerësimit, në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore, ku palë ka qenë shoqëria “****” sh.p.k., apo përfaqësuesi i saj ligjor ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, duke u ndodhur në kushtet e germës “d”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- c. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me pasurinë njësi shërbimi kanë mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar pagesën e këstit të parë të njësisë së shërbimit, duke rezultuar me një balancë negative në vitin 2010, në vlerën 1.003.580 lekë; për vitin 2012 në vlerën 1.357.110 lekë; në vitin 2013 në vlerën 2.898.089 lekë; dhe vlera e deklaruar në deklaratën *Vetting* nuk është vlera e dakordësuar prej palëve në kontratën e shitblerjes më 8.2.2013, duke u ndodhur në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, vlera e deklaruar në deklaratën *Vetting* nuk është vlera e dakordësuar prej palëve në kontratën e shitblerjes më 8.2.2013.
- ç. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për të financuar blerjen e pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz E 270 CDI”, duke rezultuar me një balancë negative në vlerën 1.182.252 lekë, duke u ndodhur në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës “b” të nenit 33.

14. Përfundimet e mësipërme u vlerësuan të mjaftueshme nga trupi gjykues për të konkluduar mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të mos pranuar kërkesën e paraqitur gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore nga përfaqësuesja ligjore e subjektit, lidhur me çelje të hetimit administrativ për dy kriteret e tjera të kontrollit të figurës dhe vlerësimin profesional.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenet 179/b, A, Ç, D dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Fida Osmani, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 27.4.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku